



Temat e Takimit:	1. Raport nga Don Ambroz Demaj mbi ecurinë e punimeve të kishës 2. Diskutim mbi vërejtjet e disa donatorëve gjatë pushimeve për cilësinë e punimeve 3. Informacione nga ekipi organizativ për fushatat e reja të donacioneve dhe mundësitë që ato ofrojnë 4. Çështje të tjera dhe pyetje të hapura
Data:	10.08.2025
Ora:	17:00 – 18:30
Vendndodhja:	Takimi u zhvillua online përmes WhatsApp-it
Pjesëmarrësit:	Don Ambroz Demaj, Marjan Gojani, Dedë Gojani, Kolë Berisha Ky takim nuk ishte i parashikuar për gjithë fshatin, por vetëm për stafin organizativ (Don Ambroz Demaj, Marjan Gojani, Kolë Berisha) si dhe për ekipin e ndërtimit dhe financave (Sokol Syla, Dedë Gojani, Nikollë Nikprelaj, Riqard Gjonaj).
Kryesuesi:	Kolë Berisha
Dokumentator:	Kolë Berisha

Përmbledhje e Takimit Online

Takimi u hap nga Kolë Berisha dhe Marjan Gojani, të cilët falënderuan pjesëmarrësit që, pavarësisht se ishte ditë e diel dhe ditë pushimi, gjetën kohë për të marrë pjesë në këtë takim të rëndësishëm. Ata shprehën mirënjohje të veçantë për donatorët për mbështetjen e tyre të vazhdueshme dhe prezantuan pikat kryesore të rendit të ditës. Pastaj ia kaluan fjalën Don Ambrozit, i cili raportoi mbi ecurinë e ndërtimit dhe gjendjen financiare, duke përmendur transparencën dhe cilësinë e punës si prioritete kryesore të projektit.

Në vijim pasqyrohen në detaje pikat e trajtuara gjatë takimit

▪ **Raporti i Don Ambroz Demaj mbi ecurinë e punimeve dhe statusin financiar:**

Don Ambrozi paraqiti një përmbledhje të ecurisë së deritanishme të punimeve në ndërtimin e kishës. Ai theksoi se procesi i ndërtimit po zhvillohet në përputhje me planin e miratuar dhe se deri më tani gjithçka po realizohet me angazhim maksimal nga të gjithë të përfshirët.

Gjithashtu, ai prezantoi një pasqyrë të qartë dhe të detajuar të hyrjeve dhe daljeve financiare. Sipas tij, deri më sot janë depozituar gjithsej 78.980 € nga donatorët, ndërsa shpenzimet për punimet kanë arritur në 54.480,42 €. Të gjitha fondet janë transferuar në llogarinë zyrtare bankare dhe janë përdorur vetëm për nevojat e ndërtimit.



Don Ambroz Demaj sqaroi se pasqyra financiare aktuale është gjithmonë në dispozicion dhe mund të prezantohet në çdo kohë që kërkohej për transparencë të plotë. Ai nënvizoi gjithashtu se çdo pagesë është realizuar vetëm pas dakordësimit dhe nënshkrimit nga ekipi përgjegjës për ndërtimin dhe financat, konkretisht nga Dedë Gojani dhe Nikollë Nikprelaj.

Në vijim, Don Ambrozi falënderoi të gjithë donatorët, të cilët me kontributet dhe bujarinë e tyre kanë bërë të mundur realizimin e këtij projekti deri në këtë pikë. Ai u bëri thirrje të gjithë atyre që kanë mundësi të vazhdojnë të mbështesin këtë proces me donacionet e tyre.

Ai falënderoi gjithashtu të gjithë aktivistët dhe bashkëpunëtorët, të cilët me përkushtim po japin një kontribut të vyer në këtë proces.

▪ Diskutim mbi vërejtjet e disa donatorëve gjatë pushimeve për cilësinë e punimeve

Don Ambrozi vazhdoi me pikën e radhës të takimit dhe sqaroi se çështja statike e kishës është trajtuar me përgjegjësi dhe profesionalizëm të lartë. Ai theksoi se elementët kryesore të strukturës statike, përfshirë themelet (Bodenfundament) dhe shtyllat mbajtëse, janë realizuar në standarde shumë të larta cilësie. Cilësia e betonit dhe e armaturës është ndër më të mirat që ofron tregu lokal, dhe kjo është vlerësuar pozitivisht nga pjesëtarë të stafit me përvojë në ndërtimtari siç është Nikollë Nikprelaj, si dhe nga inxhinierë të jashtëm që kanë bërë kontrolla të pavarura.

Don Ambrozi vuri në dukje se statika është një element kyç për jetëgjatësinë dhe sigurinë e objektit, dhe për këtë arsye i është kushtuar kujdes i veçantë gjatë zbatimit.

Sa i përket murit, ai pranoi se në disa pjesë nuk është arritur niveli i dëshiruar estetik, por sqaroi se këto mangësi nuk ndikojnë në sigurinë strukturore të objektit. Ai theksoi se bëhet fjalë kryesisht për aspekte estetike, të cilat do të rregullohen dhe do të korrigjohen në fazat e mëvonshme të punimeve, duke mos lënë gjurmë në pamjen përfundimtare të objektit.

Më tej, Don Ambrozi shpjegoi se gjatë fazës së ndërtimit, për shkak të angazhimit të disa anëtarëve të stafit të ndërtimit me të korrat gjatë verës, nuk ka qenë e mundur që të sigurohej prani dhe mbikëqyrje e vazhdueshme në punishte. Kjo ka mundur të çojë në ndonjë devijim të vogël nga cilësia e planifikuar, por pa pasoja për qëndrueshmërinë dhe sigurinë e objektit. Ai siguroi se në të ardhmen, si ai vetë ashtu edhe ekipi përgjegjës për ndërtimin do të jenë shumë më të pranishëm dhe vigjilentë, në mënyrë që të garantohet cilësi dhe kontroll i plotë i procesit të ndërtimit.

Këto sqarime u konfirmuan edhe nga Dedë Gojani, i cili i mbështeti me fjalët e tij vlerësimet dhe angazhimet e përmendura më sipër.



▪ Njoftim nga Ekipi Organizativ për Fushatat e Reja të Donacioneve

Kolë Berisha ka njoftuar se janë ndërmarrë kontakte me disa institucione për mbështetjen e ndërtimit të Kishës “Nënë Tereza” në Dugajevë. Ai bëri të ditur se nga ACN International, një organizatë katolike e mbështetur drejtpërdrejt nga Selia e Shenjtë, janë marrë sinjale shumë pozitive lidhur me mundësinë e mbështetjes financiare për këtë projekt.

Gjithashtu, Kolë Berisha theksoi se është vendosur kontakt edhe me organizatën Missio – ProEuropa, e cila ka shprehur gatishmërinë për të kontribuar me 5,000 euro. Kjo mbështetje vjen me kushtin që të paktën 50% e kostos totale të projektit, e cila arrin vlerën e rreth 275,000 eurove, të sigurohet përmes fondeve vetanake ose donacioneve nga palë të treta.

Në vijim të njoftimit, ai theksoi se ACN International, përveç sinjaleve pozitive, ka komunikuar zyrtarisht përmes email-it me Ipeshkvin e Kosovës, Mons. Dodë Gjergji, dhe me famullitarin e kishës, Don Ambroz Demaj. Ata janë informuar rreth formularëve dhe kushteve që duhen plotësuar për aplikim. Nëse dokumentacioni i kërkuar dorëzohet në kohë, i plotësuar, i nënshkruar dhe i vulosur, vendimi për shumën përfundimtare të mbështetjes pritet të merret brenda tre muajve nga data e pranimit.

Kolë Berisha bëri thirrje ndaj të gjithë përgjegjësve që të respektojnë afatet kohore dhe të jenë të kujdesshëm gjatë procesit, pasi neglizhenca mund të rrezikojë humbjen e kësaj mundësie të rëndësishme për sigurimin e donacioneve.

Nga ana e tij, Don Ambroz Demaj siguroi se brenda kësaj jave do të përmbushen të gjitha kërkesat dhe dokumentacioni do të dorëzohet në ACN International. Kjo do të ndihmojë që procedura të vazhdojë pa vonesa dhe mbështetja financiare të sigurohet sa më shpejt.

Takimi përfundoi, në një atmosferë miqesore dhe konstruktive.